



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr.

80

Prot.

Tiranë 27/03/2017

Lënda : *Për publikimin e listës së kandidatëve që kanë aplikuar për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.*

Drejtuar : Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Z. Besnik DERVISHI

Tiranë

I nderuar z. Dervishi,

Në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr.84/2016 datë 30.08.2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë", Avokati i Popullit në konsulencë të vazhdueshme me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, ka zhvilluar procesin e verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët, të cilët kanë aplikuar për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, për plotësimin e kriterëve formale ligjore të parashikuara në ligj.

Sipas kërkesës së pikës 5, dhe pikës 6, të nenit 7 të ligjit të sipërcituar, pas verifikimit të kryer për secilin kandidat kemi përpiluar një listë me kandidatët të cilët plotësojnë kriteret formale të parashikuara në ligj (emërtuar si lista A), dhe një listë me kandidatët të cilët nuk plotësojnë këto kriterë (emërtuar si lista B). Në kuadër të transparencës së këtij procesi kemi publikuar në faqen zyrtare "on-line", të Avokatit të Popullit, të dyja listat e cituara më sipër A dhe B, duke bërë publikë vetëm emrat e personave, të cilët kanë aplikuar për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, për plotësimin e kriterëve formale ligjore të parashikuara në ligj.

Në praktikën tonë të kryer të punës për këtë proces, lista B ku përfshihen kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriteret formale të ligjit ka në përmbajtjen e plotë të saj përveç emrit të kandidatit edhe të dhëna të tjera, që lidhen me pozicionet për të cilat ka aplikuar çdo kandidat, si dhe një renditje të të gjithë kriterëve ligjore që nuk plotësohen

nga ana e kandidatit, duke cituar për këtë fakt mungesën konkrete të dokumentacionit zyrtar që nuk është paraqitur nga kandidati, rast pas rasti.

Duke patur ndjeshmërinë dhe përgjegjësinë ligjore të respektimit të së drejtës së kandidatëve të paraqitur në këtë proces, për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale, gjendemi tashmë përpara faktit dhe kërkesave konkrete për bërjen publike të listës B, më të gjitha të dhënat që ne kemi sqaruar se përmban kjo listë dhe jo vetëm të emrave të kandidatëve të përfshirë në të, sikurse edhe kemi vepruar paraprakisht.

Së fundmi, në datën 24.03.2017 nëpërmjet një kërkesë, Koalicioni i shoqërisë civile "Drejtësi për të gjithë", na ka kërkuar t'i vëmë në dispozicion një kopje të listës së kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret formale për pozicionin e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit të gjyqtarëve (lista B e sipërcituar), si dhe arsyet pse këta kandidatë nuk plotësojnë krireret, sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, së bashku me një kopje të raportit të këtij institucioni për këtë qëllim.

Në këto kushte dhe për një transparencë maksimale të mundshme të procesit të kryer nga ana jonë është e nevojshme që, nga ana juaj të na jepen sqarime për këto çështje:

- A mundet që lista B, e përpiluar nga ana jonë të bëhet publike me të gjitha të dhënat ku përfshihen emrat e kandidatëve të cilët nuk plotësojnë kriteret formale të ligjit, si dhe të dhënat e tjera, që lidhen me pozicionet për të cilat ka aplikuar çdo kandidat, si dhe renditjen e të gjithë kriterëve ligjore që nuk plotësohen nga ana e kandidatit, duke cituar për këtë fakt mungesën konkrete të dokumentacionit zyrtar që nuk është paraqitur nga kandidati, rast pas rasti?
- Cila pjesë e këtij informacioni të disponuar prej nesh për listën B, mund të bëhet publik, për të respektuar dhe mbrojtur njëkohësisht edhe të drejtën për privatësi të kandidatëve në kuadër të mbrojtjes së të dhënave të tyre personale?

Sqarojmë gjithashtu se, sipas dispozitave të ligjit nr.84/2016 datë 30.08.2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë", procesi vazhdon dhe pas vlerësimit të kandidatëve nga ana e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në përputhje me modalitetet e përcaktuara në ligj, listat A dhe B, rekomandimet e mundshme të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe dosjet përkatëse individuale të kandidatëve, i përcillen Kuvendit për verifikimin përfundimtar të kandidatëve dhe votimin e tyre. Gjithashtu sqarojmë se, informacioni i kërkuar në këtë rast ka të bëjë me fazën procesit ku u verifikuan dhe listuan kandidatët pjesëmarrës, para nxjerrjes së vendimit nr.18/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, i cili përcakton rikthim të dosjeve të kandidatëve të kësaj liste tek Avokatit i Popullit dhe riplotësim të dokumentacionit të munguar, nga ana e tyre.

Sa më sipër dhe duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj, do t'ju luteshim për një përgjigje sa më të shpejtë të mundshme për çështjet e ngritura në këtë shkresë, nga ana jonë.

Me respekt

AVOKATI I POPULLIT

Iglli TOTOZANI

